



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS PODUJEVË

Numri i lëndës: 2019:170462
Datë: 21.03.2024
Numri i dokumentit: 05483369

C.nr.1795/2023

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, DEGA NË PODUJEVË, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni civil, me gjyqtarin Nazmi Neziri, dhe procesmbajtësen Afërdita Ejupi, në çështjen juridike kontestimore të paditëses Korporata Energjetike e Kosovës nga Prishtina, Bulevardi Nënë Tereza nr. ..., të cilën e përfaqëson i autorizuari i saj A. Sh., me autorizim, kundër të paditurit E. Sh. nr. personal, nga Prishtina, Rruga Z. G.” nr. ..., Lagjja “S. e R.”, të cilin e përfaqëson i autorizuari A. S., avokat nga Podujeva, Rruga “N. G.” pn., me autorizim, me objekt kontesti Kompensim dëmi material, me vlerë të kontestit: 1,538.86 Euro, në shqyrtimin kryesor publik të mbajtur, në prani të autorizuarit të paditëses dhe të autorizuarit të të paditurit, më datën 15.03.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

APROVOHET kërkesëpadia e paditëses Korporata Energjetike e Kosovës nga Prishtina, Bulevardi Nënë Tereza nr. ..., në tërësi **si e bazuar**.

DETYROHET i padituri E. Sh. Sh. nga Prishtina, Rruga “Z. G.” nr..., Lagjja “S. e R.”, që paditëses në emër të kompensimit të dëmit material në emër të rikthimit të humbjeve, t’ia paguajë shumën prej 1,538.86 (njëmijë e pesëqind e tridhjetë e tetë euro e 86 centë) eurove, me kamatën ligjore të cilën e paguajnë Bankat Komerciale në Kosovë, për mjete të deponuara në afat mbi një vit, e pa destinim të caktuar, duke filluar nga data e nxjerrjes së këtij aktgjykimi e deri në pagesën përfundimtare, të gjitha në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, e nën kërcënimin e përmbarimit.

Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës.

A r s y e t i m

Paditësja, ka kërkuar nga gjykata që të aprovohet kërkesëpadia dhe të detyrohet i padituri që në emër të dëmit material të shkaktuar paditëses t’ia paguajë shumën prej 1,538.86 euro, me kamatë

ligjore. Ka shtuar se mbesim në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë duke kërkuar nga gjykata që ta obligoj të paditurin ta shlyej obligimin ndaj paditëses, për kompensimin e dëmit të shkaktuar në emër të rikthimit të humbjeve në shumën prej 1,538.86Euro.

Më tej ka shtuar se mbesim pranë të gjitha deklarimeve duke i propozuar gjykatës që të paditurin ta obligoj që në emër të kompensimin të dëmit material të shkaktuar ndaj paditëses t'ia paguaj shumën prej 1,538.86 Euro, me kamatë ligjore të cilën e paguajnë Bankat Komerciale në Kosovë për mjete të deponuara me afat mbi një vit pa destinim të caktuar.

Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

I autorizuari it të padituri në seancën e shqyrtimit kryesor ka deklaruar se mbesim në tërësi pranë përgjegjës në padi, deklarimeve të palës së paditur lidhur me kundërshtimet mbi bazën se kërkesëpadia se e njëjta është e mangët në mungesë të provave dhe jo e plotë me të cilën zbeh bazën e kërkesëpadisë, bazën juridike si dhe lartësinë e dëmit në të cilën ka vërtetuar edhe Gjykata e Apelit se gjejnë bazë pretendimet e palës së paditur.

Ka shtuar se pas administrimit që është bërë, të gjitha provat që gjenden në shkresat e lëndës shihet qartë se paditësja nuk ka arrit të dëshmoj me asnjë provë bazën e kërkesëpadisë si dhe lartësinë e dëmit të cilin e kërkon nga pala e paditur. Kjo është vërejtur edhe nga Gjykata e Apelit e cila ka udhëzuar palën paditëse në bazë të aktgjykimit që padinë ta plotësoj me prova me anë të ekspertit nga fusha e elektros apo edhe nga eksperti financiar për përllogaritjen e dëmit të shkaktuar, një gjë e tillë nga pala paditëse është injoruar dhe tejkaluar gjë që njehërit nuk ka ndonjë interes për nxjerrjen e këtyre provave, mbi bazën e tyre.

Prandaj, nga arsyet e cekura i ka propozuar gjykatës që ta refuzoj kërkesëpadinë e paditëses si të pa bazuar.

Shpenzimet procedurës i ka kërkuar për një seancë, shumën prej 135 euro, sipas TAOK-së.

Gjykata për vlerësimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike në këtë çështje juridike në procedurën e të provuarit i ka administruar këto prova: u lexua Aktvendimin Pnr.1188/2011 dt.27.04.2015 i kësaj gjykate, Fatura DPR11HP.... dt.04.10.2011 në emër të paditurit, Përgjigje në padi nga i padituri dt.25.02.2020, Aktgjykim i kësaj gjykate me numër C.nr.243/2015 dt.29.01.2021, Ankesë nga i padituri dt.23.02.2021, Aktvendim i Gjykatës së Apelit të Kosovës me numër AC.nr.2621/2021, dt.14.11.2023, Procesverbal i kësaj gjykate me numër C.nr.1795/23 dt.23.01.2024, Procesverbal i kësaj gjykate me numër C.nr.1795/23 dt.15.02.2024, Kërkesë e dt.15.02.2024.

Pasi që gjykata e bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, mbështetur në dispozitat nga neni 8 i LPK-së, arriti në përfundimin se në këtë çështje juridike civile duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye:

Nuk është kontestues fakti se dëmi i shkaktuar paditëses është në shumën prej 1,538.86 €, duke qenë se i padituri prej datës së pavërtetuar e deri me datën 09.09.2011, me qëllim që vetit ti sjellë pasuri të kundërligjshme ka shfrytëzuar energjinë elektrike në mënyrë të paautorizuar, në njehsorin elektrik nr.17723005 nëpërmes të cilit është furnizuar me energji elektrike, me qëllim të shmangies së pagesës së energjisë elektrike të shpenzuar ka bërë asgjësimin e provave bindëse

të keqpërdorimit të njehsorit me të cilin veprim i ka shkaktuar dëm material paditësit në vlerën e kërkuar. Ky fakt u vërtetua me prova materiale që gjenden në shkresa të lëndës.

Nga fatura me numër DPR-11HP... të datës 04.10.2011, në emër të paditurit për rikthimin e humbjeve, gjykata ka vërtetuar se vlera e dëmit të shkaktuar paditëses nga këtu i padituri është vlera prej 1,538.86 €uro.

Të cilës provë gjykata ia fali besimin e plotë për faktin se me mos paraqitjen e propozimeve nga palët ndërgjyqjese për nxjerrjen e provave për vërtetimin e gjendjes së kundërt të kësaj prove, edhe pse këtë e kanë obligim konform nenit 7 dhe 319 të LPK-së, atëherë gjykata vlerësoi se me këtë është vërtetuar si baza e kërkesëpadisë dhe vetë lartësia e saj, gjegjësisht dëmit të shkaktuar nga i padituri ndaj paditëses.

Meqë i padituri i ka shkaktuar dëm paditëses dhe kjo rrethanë u vërtetua me prova në procedurë, atëherë gjykata duke u bazuar në nenin 154 par.1 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve – LMD-së (Gazeta Zyrtare RSFJ-së nr.29/78), në të cilin është përcaktuar se: *“Kush tjetrit i shkakton dëm e ka për detyrë t’i kompensojë në qoftë se nuk e provon se dëmi ka lindur pa fajin e tij.”*, interpretimit të kësaj dispozite, vlerëson se kjo do të thotë se pala e paditur është e obliguar t’ia kompensojë dëmin palës së dëmtuar me vepër penale në këtë rast në shumën prej 1,538.86€.

Me nenin 158 të LMD-së, është paraparë se: *“Fajësia ekziston kur dëmtuesi e ka shkaktuar dëmin me dashje ose nga pakujdesia.”*, andaj po t’i referohemi kësaj dispozite lidhur me ekzistimin e fajësisë atëherë ky fakt vërtetohet se tek i padituri ekziston fajësia sipas aktvendimit penal të formës së prerë të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Dega në Podujevë P.nr.1188/2011 dt.27.04.2015, me të cilin është hudhë aktakuza ndaj këtu të paditurit për veprën penale Vjedhje nga neni 252 par.1 i KPK-së.

Po ashtu se palës paditëse i takon e drejta për kompensimin e dëmit kjo kërkesë bazohet dhe në dispozitat e nenit 185 par.2, 3 dhe 4 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (Gazeta Zyrtare RSFJ-së nr.29/78).

Prandaj, pasi që u konstatua përgjegjësia-faji i të paditurit në shkaktimin e dëmit paditëses si dhe lartësia e dëmit të shkaktuar, gjykata erdhi në përfundim se padia e paditëses është e bazuar, andaj si të tillë e aprovoi në tërësi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata me rastin e vendosjes vlerësoi dhe pretendimet e të paditurit të dhëna në përgjigje në padi, por vlerësoi se të njëjtat ishin pa ndonjë ndikim në vendosjen ndryshe ngase është vendosur në dispozitiv të këtij aktgjykimi, kjo konform dhe dispozitës së nenit 14 të LPK-së, ku është përcaktuar se: *“Në procedurën kontestimore gjykata, në pikëpamje të ekzistimit të veprës penale dhe të përgjegjësisë penale të kryerësit, është e lidhur me aktgjykimin e formës së prerë të gjykatës penale, me të cilin i pandehuri është shpallur fajtor.”*

Vendimi mbi kamatën që e njëjta të paguhet nga dita e nxjerrjes së këtij aktgjykimi i është llogaritur konform nenit 277 të LMD-së.

Vendimi lidhur me shpenzimet e procedurës kontestimore u mor konform dispozitave të nenit 450 të Ligjit Nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore (LPK-së).

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi konform nenit 151.1 të LPK-së.

**Gjykata Themelore në Prishtinë, Dega në Podujevë, Departamenti i Përgjithshëm
C.nr.1795/2023, me datën 15.03.2024**

Gjyqtari:
Nazmi Neziri

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e pranimit pranë Gjykatës së Apelit, përmes kësaj Gjykate.